

Mundësi për Bashkitë për aplikim në Thirrjen e 7-të për Projekte të Vogla nën programin Interreg VI-A IPA III CBC Greqi-Shqipëri 2021–2027

Kodi i thirrjes: 7th GR-AL 4.6

1. Synimi i thirrjes:

Thirrja e 7-të synon të forcojë rolin e kulturës dhe turizmit të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe inovacionin social në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri.

Në mënyrë më specifike, thirrja synon ruajtjen dhe promovimin e destinacioneve alternative dhe të produkteve të ndryshme turistike, duke përfshirë turizmin kulturor, ekologjik, agro-turizmin, turizmin kulinar, të verës, fetar dhe sportiv. Këto ndërhyrje duhet të zhvillohen përmes bashkëpunimit ndërkufitar, digjitalizimit dhe parimeve të turizmit të qëndrueshëm, me synim rritjen e atraktivitetit, aksesueshmërisë dhe potencialit ekonomik të zonës ndërkufitare. Thirrja i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes dhe promovimit të traditave, njohurive lokale dhe zejeve, si dhe forcimit të kapaciteteve të organizatave kulturore për përdorimin e teknologjive dhe mjeteve të reja digjitale. Një element themelor është karakteri ndërkufitar i projekteve. Partnerët nga Shqipëria dhe Greqia duhet të bashkëpunojnë për ruajtjen dhe promovimin e aseteve të përbashkëta kulturore ose natyrore, krijimin e produkteve dhe itinerareve të integruara turistike, zhvillimin e një identiteti më të fortë turistik ndërkufitar, shkëmbimin e njohurive dhe përdorimin e zgjidhjeve digjitale.

Thirrja rekomandon veçanërisht përfshirjen e **bashkive më të vogla, organizatave dhe shoqatave lokale kulturore ose turistike dhe komuniteteve rinore**, në mënyrë që traditat, zejet, gastronomia dhe asetet kulturore ose natyrore lokale të shndërrohen në oferta turistike të aksesueshme dhe të lidhura me itinerare më të gjera ndërkufitare.

2. Kush mund të aplikojë:

Subjektet e pranueshme për të aplikuar janë:

Organet publike rajonale (qarqet) ose vendore (bashkitë).

Organizatat jofitimprurëse, me kusht që të mos jenë krijuar për qëllim fitimi, të mos shpërndajnë fitime tek aksionarët dhe të kenë të paktën një vit të plotë aktiviteti financiar përpara hapjes së thirrjes.

Kërkesa të rëndësishme për partneritetin

Një projekt nuk mund të paraqitet nga një bashki e vetme.

Partneriteti duhet të përfshijë të paktën **2 përfitues**, një nga Shqipëria dhe një nga Greqia, ndërsa numri maksimal është **4 përfitues**. Partnerët duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e projektit, si dhe në financimin dhe/ose sigurimin e stafit për projektin.

Një institucion mund të marrë pjesë **vetëm në një projektpropozim** në kuadër të kësaj thirrjeje. Ky kufizim zbatohet në nivel të institucionit dhe jo në nivel drejtorie, sektori apo njësie. Nëse një përfitues merr pjesë në më shumë se një projekt, vetëm projektpropozimi i parë i dorëzuar përmes MIS do të vlerësohet; projektet e tjera ku ai përfitues merr pjesë do të refuzohen.

3. Cilat janë fushat dhe tipet e aktiviteteve:

Thirrja është e fokusuar në **RSO4.6 – Kultura dhe turizmi i qëndrueshëm** dhe ka dy fusha kryesore ndërhyrjeje:

Fusha 165 – Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i aseteve publike turistike dhe shërbimeve turistike.

Fusha 166 – Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe shërbimeve kulturore.

Çdo projekt duhet të lidhet me vetëm një nga këto dy fusha. Nëse një projekt përfshin të dyja, duhet të zgjidhet fusha që ka pjesën më të madhe të buxhetit. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë, ndër të tjera, promovimin digjital të siteve kulturore, digjitalizimin e informacionit kulturor, organizimin e aktiviteteve dhe eventeve kulturore, ekspozita, workshope dhe fushata të përbashkëta për promovimin e destinacioneve kulturore dhe turistike. Mund të mbështeten gjithashtu rrjetëzimi i industrive kulturore dhe kreative, forcimi i kapaciteteve të tyre, trajnimi, promovimi i shërbimeve kulturore, zhvillimi i klasterëve të industrive kreative dhe përmirësimi i aftësive digjitale të këtyre industrive. Në sektorin e turizmit mund të mbështeten aktivitete për forcimin e kapaciteteve, inovacionin social, përmirësimin e aftësive profesionale, përfshirjen sociale, aftësimin dhe rikualifikimin për transformimin e gjelbër dhe digjital të sektorit, turizmin e aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe zbatimin e parimeve të qëndrueshmërisë. Mund të financohen edhe iniciativa që promovojnë qasjet rrethore dhe miqësore ndaj klimës në sektorin e turizmit, me qëllim reduktimin e ndikimit të aktiviteteve turistike mbi mjedisin. Në praktikë, për një bashki shqiptare, projektet mund të orientohen drejt krijimit të produkteve të përbashkëta turistike me një bashki ose institucion grek, zhvillimit të itinerareve kulturore ndërkufitare, promovimit digjital të trashëgimisë, zhvillimit të ofertave të turizmit gastronomik ose agro-turizmit, promovimit të zejeve dhe traditave lokale, trajnimit të aktorëve lokalë të turizmit, si dhe krijimit të platformave ose mjeteve digjitale për promovimin e destinacioneve. Një projekt mund të synojë gjithashtu mobilizimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre aktive në komunitet, aspekt që thirrja e rekomandon në mënyrë të veçantë.

4. Cilat janë zonat përfituese:

Për Shqipërinë, zonat e pranueshme janë këto **5 qarqe/njësi rajonale**:

Berat – AL031

Fier – AL032

Gjirokastrë – AL033

Korçë – AL034

Vlorë – AL035

Kjo do të thotë se, nga **61 bashkitë e Shqipërisë, vetëm bashkitë që ndodhen brenda këtyre pesë qarqeve** mund të jenë përfituese në këtë thirrje.

Në Greqi, zona e Programit përfshin njësitë rajonale Florina, Grevena, Kozani, Arta, Zakynthos, Preveza, Kefallinia, Ioannina, Thesprotia, Lefkada, Kastoria dhe Kerkyra.

Në parim, aktivitetet e projektit duhet të zhvillohen **brenda zonës së Programit**. Përjashtime mund të lejohen për shpenzime udhëtimi dhe akomodimi jashtë zonës, vetëm kur ato janë të justifikuara, në interes të zonës së Programit, thelbësore për projektin dhe të miratuara sipas rregullave të Programit.

5. Cili është buxheti i thirrjes dhe buxheti për projekt:

Buxheti i përgjithshëm i Thirrjes së 7-të është **2,000,000 EUR**, i përbërë nga fondet e BE-së dhe fondet kombëtare.

Kontributi i BE-së është **80%**, ndërsa përfituesit duhet të sigurojnë kontributin e tyre, publik dhe/ose privat, sipas rastit.

Për një projekt individual:

- Buxheti minimal i projektit: **120,000 EUR**.
- Buxheti maksimal i projektit: **400,000 EUR**.

Për secilin partner:

- Buxheti maksimal: **200,000 EUR**.

Nuk ka një kufi minimal buxheti për partner. Kjo do të thotë se, në një projekt me dy partnerë, për shembull një bashki shqiptare dhe një partner grek, buxheti total mund të jetë deri në 400,000 EUR, me jo më shumë se 200,000 EUR për secilin partner.

Projektet duhet të përfundojnë fizikisht dhe financiarisht deri më **31 dhjetor 2029**.

Projektet duhet të përfundojnë brenda një periudhe maksimale prej **18 muajsh nga nënshkrimi i kontratës së grantit**.

6. Cilat janë kostot e pranueshme:

Thirrja parashikon dy metoda të financimit, dhe çdo përfitues duhet të zgjedhë shprehimisht njërin prej tyre. Partnerët brenda të njëjtit projekt mund të përdorin metoda të ndryshme, në varësi të strukturës së aktiviteteve të tyre. Zgjedhja nuk mund të ndryshohet gjatë zbatimit të projektit.

Opsioni 1: Kostot e stafit si kosto reale dhe kostot e tjera me normë fikse.

Kostot direkte të stafit llogariten mbi bazën e kostove reale bruto të punësimit. Kostot e tjera të projektit mbulohen me një normë fikse deri në 40% të kostove direkte të pranueshme të stafit. Kjo përfshin administrimin dhe zyrën, udhëtimet dhe akomodimin, pajisjet dhe ekspertizën/shërbimet e jashtme. Në këtë opsion, përfituesi duhet të justifikojë kostot e stafit me dokumente përkatëse, si dokumentet e punësimit, listëpagesat, vendimet e emërimit dhe timesheet-et.

Opsioni 2: Kostot direkte si kosto reale dhe stafi, administrimi dhe udhëtimet me normë fikse.

Kostot direkte përfshijnë pajisjet dhe ekspertizën/shërbimet e jashtme dhe llogariten si kosto reale.

Kostot e stafit llogariten me normë fikse deri në 20% të kostove direkte, ndërsa kostot e administrimit/zyrës dhe udhëtimet/akomodimit llogariten me normë fikse deri në 15% të kostove direkte të stafit. Kujdes i veçantë për bashkitë: në këtë thirrje “Infrastructure and Works” nuk është kategori e pranueshme për projektet Small-Scale nën objektivin specifik 4.6 për Kulturën dhe Turizmin e Qëndrueshëm. Pra, kjo nuk është një thirrje për financimin e punimeve infrastrukturore fizike të tilla si rikonstrukcione, ndërtime apo rehabilitime infrastrukturore.

Kjo e bën Thirrjen 7 dukshëm të ndryshme nga disa thirrje të tjera të Programit: fokusi duhet të jetë te produktet turistike dhe kulturore, shërbimet, digjitalizimi, promovimi, ekspertiza, trajnimi, rrjetëzimi dhe aktivitetet ndërkufitare, jo te ndërtimi apo rikonstrukcioni i infrastrukturës..

7. Si bëhet aplikimi?

Aplikimi bëhet **vetëm në mënyrë elektronike në sistemin MIS** të Programit.

Platforma e aplikimit është: <https://logon.ops.gr/>

Aplikimi duhet të dorëzohet nga **Përfituesi Kryesor (Lead Beneficiary)**, në emër të të gjithë partneritetit. Formulari i aplikimit plotësohet ekskluzivisht në formatin elektronik në MIS. Përfituesit duhet të plotësojnë formularin dhe të ngarkojnë të gjitha dokumentet e detyrueshme brenda afatit.

8. Kur është afati i fundit:

Afati përfundimtar për dorëzimin e projektpropozimeve është: **30 shtator 2026, ora 15:00 (Ora e Greqisë).**

9. Linku i thirrjes:

<https://greece-albania.eu/call/7th-open-call-for-small-scale-project-proposals-under-s-o-4-6/>